



GARA SHKETËRORE NE
SHKENCAT NATYRORE për
klasët e IV
(përgjigjet)
(07.qershor 2026)

1. Lexo pohimet dhe rretho S nëse pohimi është i saktë ose J nëse pohimi është i pasaktë.

| | | | |
|----|--|----------|----------|
| A) | Nëse të njëjtat vëllime uji lihen në një enë të cekët dhe të gjerë dhe në një enë të thellë dhe të ngushtë, uji në enën e cekët dhe të gjerë do të avullojë më shpejt. | S | J |
| B) | Pikat që shfaqen në anën e jashtme të një gotë të ftohtë vijnë nga uji në gotë. | S | J |
| B) | Avullimi ndodh vetëm kur lëngu arrin temperaturën e vlimit. | S | J |
| Γ) | Acetoni vlon në 56 °C, që do të thotë se ka temperaturë më të lartë vlimi se ajo e ujit. | S | J |
| Δ) | Temperatura e shkrirjes së akullit është e njëjtë me temperaturën e ngrirjes së ujit. | S | J |
| Í) | Nëse një enë është e mbushur me lëng deri në gjysmën e vëllimit të saj dhe është e mbyllur plotësisht (hermetikisht), lëngu nuk mund të avullojë. | S | J |
| E) | Gazi natyror është një burim energjie i papërtërishëm dhe gjatë djegies së tij kontribuon në ndotjen e mjedisit. | S | J |
| Ж) | Koha me re dhe e ftohtë e ngadalëson procesin e avullimit. | S | J |

Gjithsej 8 pikë (nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë).

2. Cilat nga shembujt e mëposhtëm paraqesin ndryshim të gjendjes agregate? (Për të marrë pikët, pyetja duhet të përgjigjet PLOTËSISHT saktë)

a) Zhdukja e një pellgu të vogël uji nga asfalti pasi ka qenë i ekspozuar për disa orë në diell.

b) Mykësimi i një molle

c) Formimi i vesës në bar në mëngjes

d) Shkrirja e dyllit të qiririt gjatë djegies

e) fërgim i vezës

Gjithsej 3 pikë (vetëm nëse të gjitha përgjigjet janë të rrethuara saktë).

3. Në tabelë janë dhënë shembuj nga jeta e përditshme që paraqesin një ndryshim të gjendjes agregate dhe atë:

- A. Shkrirje
- B. Avullim
- C. Kondensim
- D. Ngrirje

Në kolonën e dytë shkruaj **NJË SHKRONJË** që i përgjigjet ndryshimit përkatës.

| Shembull | Ndryshimi |
|---|-----------|
| 1. Xhami i makinës në mëngjes është i mjegulluar me pika të imta uji. | |
| 2. Një kub akulli në një gotë me lëng gradualisht shndërrohet në ujë të lëngshëm. | |
| 3. Një leckë e lagur e lënë në ballkon bëhet e thatë pas disa orësh. | |
| 4. Uji nga një pellg i vogël në rrugë shndërrohet në akull kur temperatura është nën 0°C. | |

| Ndryshimi | | | |
|-----------|----------|----------|----------|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| C | A | B | D |

Gjithsej 4 pikë (nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë).

4. Lidhi dukurit natyrore me sferën e Tokës ku përkasin!

Sferat: atmosfera, hidrosfera, litosfera, biosfera

| | |
|------------------|-------------------|
| Cunami | hidrosfera |
| Tërmete | litosfera |
| Retë | atmosfera |
| Burim nëntokësor | hidrosfera |
| Reshje | atmosfera |

5. Kompania për prodhimin e energjisë elektrike në Maqedoni ka dhënë këtë njoftim: “Gjatë ditës së djeshme, $\frac{6}{10}$ e energjisë së përgjithshme elektrike e nevojshme për banorët e Maqedonisë është prodhuar në termocentrale që punojnë me qymyr dhe gaz natyror, $\frac{3}{10}$ është prodhuar në termocentrale që përdorin energjinë e ujit dhe $\frac{1}{10}$ është prodhuar nga termocentrale që përdorin energjinë e erës”.

a) Sa pjesë e energjisë është prodhuar nga burime të rinovueshme të energjisë?

_____ **Përgjigje: $\frac{4}{10}$**

b) A prodhohet sasi më e madhe e energjisë elektrike në Maqedoni duke përdorur burime të rinovueshme apo jo të rinovueshme?

_____ **Përgjigje: burime jo të rinovueshme**

c) Cili burim i rinovueshëm i energjisë nuk është përdorur fare për të prodhuar energji elektrike në ditën e lartpërmendur?

_____ **Përgjigje: energjia diellore**

(secila nga 1 pikë)

3/

6. Pse në filma, sa herë që duan të rrëmbejnë dikë, i vënë një copë pëlhere në gojë që të mos mund të kërkojnë ndihmë?

3/

Përgjigje: që pjesë e energjisë me të cilën oscillojnë grimcat kur flasin të zvogëlohet, me këtë zvogëlohet edhe intensiteti i zërit. Pranohet edhe gjithçka që është në kontekst të njëjtë si më sipër.

7. Telekomandat përdorin burim energjie me dy bateri. Nëse bateritë vendosen saktë, telekomanda funksionon, por nëse njëra prej baterive nuk është vendosur saktë, atëherë telekomanda nuk funksionon fare. Pse?


2/

Përgjigje: burimi i rrymës elektrike në qark nuk është mjaft i fuqishëm për të siguruar fuqinë e kërkuar.




8. Gjatë ekskursionit të fundit shkollor, Nadja dhe Bekimi u ndanë nga shokët e klasës ndërsa bënë ecje në natyrë dhe nuk ishin të sigurt se cilën rrugë duhet të ndiqnin për t'u kthyer në Shkup. Ajo që mbajtën mend nga shpjegimi hyrës i mësueses është se ka 3 kryqëzime: në të parin duhet të vazhdojnë afërsisht në perëndim, në të dytin drejt lindjes dhe në të tretin afërsisht në veriperëndim. Në fund, ata përsëri kthehen në pozicionin fillestar nga ku duhet të kthehen në juglindje për të arritur në Shkup. Për fat të mirë, Bekimi kishte një busull në çantën e shpinës, kurse Nadja mbajti mend se ata tashmë e kishin kaluar kryqëzimin e parë, kështu që mund të përdornin udhëzimet e mësuara përmendësh.



Shembull për shënimin e pozicionit të busullës:






A) Ndhimojini ata të zgjedhin pozicionet e sakta të gjilpërës magnetike në busullë për t'u kthyer në qytetin e Shkupit.

| Lëvizja e Nadjës dhe Bekimit | Pozicioni i gjilpërës magnetike në busullë |
|--|---|
| Kthehen afërsisht kah lindja në 2 |  |
| Kthehen afërsisht kah veriperëndimi në 3 |  |
| Kthen afërsisht kah juglindja drejt pozicionit fillestar (flamuri) |  |

(secila përgjigje vlerësohet me 1 pikë)

B) Duke i ndjekur udhëzimet e dhëna nga busulla, Nadja e pyeti Bekimin se si gjilpëra magnetike e busullës e dinte saktësisht se ku ishte veriu, mirëpo ai nuk e dinte përgjigjen. Shpjegoji Nadjës se si funksionon busulla.

Përgjigje: Gjilpëra e busullës është një magnet (1 pikë) në të cilin vepron fusha magnetike e Tokës (1 pikë). Polet e gjilpërës orientohen në drejtimin veri-jug, ashtu siç deshtë e orientuar fusha magnetike e Tokës (1 pikë).

| Përgjigje | Përgjigje | |
|--|--|--------|
| A. Duke u kthyer në lindje në orën 2 |  | 1 pikë |
| B. Duke u kthyer në veriperëndim në orën 3 |  | 1 pikë |
| C. Duke u kthyer në juglindje kah pozicionit fillestar (flamuri) |  | 1 pikë |

9. Cili nga termat e mëposhtëm mund të jetë konsumator në një qark elektrik?

a) llamba

b) cingëruesja (zhurmuesja)

c) zilja

d) të gjitha përgjigjet e mëparshme

e) asnjë nga përgjigjet e ofruara

(1 pikë; pranohet gjithashtu nëse të tre janë të rrethuara: a, b, c)

10. Luleradhiqja (Taraxacum) në prani të dritës lëviz dhe krijon ushqim. Gjatë këtij ngacmimi (stimuli), cila veçori aktivizohet e para?

- a) Krijimi i ushqimit
- b) Ndjeshmëria**
- c) Lëvizja
- d) Frymëmarrja

1/

11. Shëno organet përkatëse përmes të cilave mund të marrin frymë lloje të ndryshme organizmash.

Bimët marrin frymë përmes **rrënjët, gjetheve,**

ndërsa kafshët përmes

mushkërive, verëzave, lëkurës, traketë

2 pikë / 2 ose 0.

Për bimët, pranohet nëse shkruhen rrënja dhe/ose gjethet (nëse shkruhen njëri nga këto dy terma ose të dy termat, pranohet). Për kafshët, nëse shkruhen tre nga termat e mëposhtëm: mushkëri, verëza, lëkurë, trake.

* **Shpjegim:** Në faqen 46 të librit shkollor, thuhet se bimët marrin frymë përmes gjetheve të tyre, duke thithur dioksid karboni dhe duke nxjerrë oksigjen. Ky shkëmbim gazrash ndodh përmes procesit të fotosintezës. Procesi i frymëmarrjes te bimët bëhet përmes rrënjës, duke thithur oksigjen dhe duke lëshuar dioksid karboni.

12. Gaforret, arinjët dhe iriqët grupohen në një grup të vetëm nëse merret parasysh:

- a) prania e shtyllës kurrizore
- b) vendi i jetesës
- c) mënyra e të ushqyerit**
- d) mënyra e frymëmarrjes

2/

13. Ndarja më themelore e kafshëve sipas ndërtimit të tyre është në jokurrizorë dhe kurrizorë. Jokurrizorët përfshijnë shumë lloje të ndryshme, prandaj janë ndarë në disa grupe, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe këmbënyjorët (artropodët). Si ndahen këmbënyjorët ?

Përgjigjja e saktë: **Akrepat, merimangat, gaforret dhe insektet**

2/

14. Për kafshën e paraqitur në figurë, në tabelat më poshtë janë dhënë disa përshkrime.


Në hapësirat bosh pranë secilit përshkrim shkruaj nëse ai është **I SAKTË** ose **I PASAKTË**.

Shënim: Vetëm përgjigjja e plotë për secilin çift në tabelë vlerësohet me **1 pikë**



| | |
|--|------------------|
| Kafsha i përket grupit të zvarranikëve | E PASAKTË |
| Kafsha gjatë ciklit të jetës jeton si në tokë ashtu edhe në ujë | E SAKTË |
| Kafsha ka temperaturë të qëndrueshme (përherëshme) të trupit | E PASAKTË |
| Kafsha nuk ka qafë | E SAKTË |
| Kafsha gjatë ciklit të saj jetësor merr frymë përmes verëzave, lëkurës dhe mushkërive. | E SAKTË |
| Kafsha merr frymë vetëm përmes mushkërive | E PASAKTË |
| Kafsha riprodhohet duke lindur të vegjë | E PASAKTË |
| Kafsha ka lëkurë me luspa | E PASAKTË |

15. Shiko figurat e llojeve dhe me ndihmën e çelësit për identifikim, vendosi organizmat e paraqitur në fushat bosh në fund të çelësit sipas karakteristikave të tyre.



5/

Vlerësimi sipas skemës

D – A – Nëse pyetja e parë është përgjigjur gabim, duke u përzier jokurrizorët me kurrizorët, nuk jepet asnjë pikë (nëse kombinimi përfshin shumëkëmbëshin, krimbin dhe yllin e detit – jepen pikë; nëse përfshihet një kurrizor, nuk jepen pikë).





BRESHKA



QINDKËMBËSHI



KRIMB

| | |
|--|------------------|
|  | <p>YLL DETI</p> |
|  | <p>PESHKAQEN</p> |